

ADTN sh.a
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

1. Informacion i përgjithshëm

ADTN sh.a ("Shoqëria") është themeluar më 13.09.2016 , regjistruar më 21.09.2016 në QKR. Kapitali i Shoqërisë është 3,500,000 lekë

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ndërtimi dhe tregtimi i sistemeve të telekomunikacionit, prodhimi i shërbimeve audio dhe video.

Përfaqësues Ligjor i Shoqërisë është z. Andi Cenko .

Shoqëria drejtohet nga Këshilli Mbikqyrës i cili përbëhet nga :

- Dritan Shakohoxha
- Agim Pocari
- Arjan Shkempi

Selia e Shoqërisë ndodhet në Rrugen "Pavarësia", Nr. 39, Kashar, Tiranë.

Shoqëria është rregjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë me NIPT L62121006Q

Shoqëria më 31 dhjetor 2018 ka 10 punonjës të regjistruar (2017: 10 punonjës) .

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

*(Vlerat janë në Lek)***2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)****2.5 Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3 Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR/LEK	123.42	132.95
USD/LEK	107.82	111.10

3 Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3 Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4 Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë

3.5 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

3.13 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht. Ndryshimet përfshijnë riklasifikime brenda zërave të seksionit të aktiveve dhe pasiveve në pasqyrën pozicionit financiar si edhe në pasqyrën të fitim humbjes.

ADTN sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

4. Mjete monetare

Balancat e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si në vijim:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Mjete monetare në bankë	1,183,640	475,912
Mjete monetare në arkë	33,100	33,100
	<u>1,216,740</u>	<u>509,012</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Balancat e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si në vijim :

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Klientë rrjeti tokësor	20,460,000	-
	<u>20,460,000</u>	<u>-</u>

6. Llogari të arkëtueshme të tjera

Balancat e llogarive të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si në vijim :

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
TVSH e zbritshme	-	132,242
	<u>-</u>	<u>132,242</u>

7. Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2018 është në vlerën 3,500,000 Lekë, i cili zotërohet nga aksioneri i shoqërisë.

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Numri aksioneve	1	1
Vlera nominale	3,500,000	3,500,000
	<u>3,500,000</u>	<u>3,500,000</u>

Humbjet e mbartuara më 31 dhjetor 2018 është (25,493,678) Lek, [2017: (2,393,638)] .
Rezultati i ushtrimit më 31 dhjetor 2018 është 2,097,402 lek, [2017: (23,100,040)].

ADTN sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

8. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Furnitorë	9,075,867	778,451
	<u>9,075,867</u>	<u>778,451</u>

9. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	190,859	202,143
Tatimi mbi të ardhurat personale	110,493	72,338
TVSH për tu paguar	433,253	-
	<u>734,605</u>	<u>274,481</u>

10. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Llogari të pagueshme ndaj shoqërisë Digit- Alb	31,762,544	21,582,000
	<u>31,762,544</u>	<u>21,582,000</u>

11. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	31,588,000	-
	<u>31,588,000</u>	<u>-</u>

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në

Qarkullim i tatueshëm

Sipas Kontabilitetit

Diferenca

31 dhjetor 2018

31,588,000

31,588,000

-

ADTN sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Vlerat janë në Lek)

12. Materiale dhe shërbime direkte

Materialet dhe shërbimet direkte për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Licenca dhe shpenzime të rrjetit tokësor	17,230,070	10,938,000
	<u>17,230,070</u>	<u>10,938,000</u>

Në periudhën e mëparshme raportuese Licenca dhe shpenzime të rrjetit tokësor janë paraqitur në notën "Shpenzime të tjera". Në periudhën aktuale raportuese Licenca dhe shpenzime të rrjetit tokësor janë klasifikuar si "Material dhe shërbime direkte". Për efekt krahasueshmërie shifrat krahasuese të periudhës së mëparshme janë riparaqitur.

13. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzime paga	10,081,468	9,836,590
Shpenzime për sigurime shoqërore	1,389,076	1,466,594
	<u>11,470,544</u>	<u>11,303,184</u>

14. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë :

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>
Shpenzim mirëmbajtje	1,643	22,309
Qera	500,000	500,000
Komisione dhe tarifa bankare	7,305	9,510
Taksa vendore	101,000	101,000
Taksa të ndryshme	-	66,810
Shpenzime të ndryshme	60,036	159,227
Shpenzime konsulence dhe auditimi	120,000	-
	<u>789,984</u>	<u>858,856</u>

*(Vlerat janë në Lek)***15. Tatim fitimi**

Shpenzimet e tatim fitimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
<i>Fitimi para tatimit</i>	2,097,402	(23,100,040)
Total shpenzime të panjohura	59,852	58,217
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	2,157,254	(23,041,823)
Humbje fiskale e mbartur	(25,435,461)	(2,393,638)
Fitim/Humbje e tatueshme	(23,278,207)	(25,435,461)
<i>Tatim fitimi @15%</i>	2,097,402	(23,100,040)

16. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

17. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.